

## KOMUNA E SHTIMËS

### ZYRA E PROKURIMIT

Nr. 03/01/59

Datë 27.9.2018

### KONTRATË KONKURS I PROJEKTIMIT- SHËRBIM

**Komuna Shtime** Rr. „Tahir Sinani „ tel. 0290-389-016-131 ose 045-444-509 që e përfaqëson Havë QARRI-u.d.Menaxheri i Prokurimt në njëren anë: dhe

**INSTITUTI I SHKENCËS DHE I TEKNOLOGJISË " INSI " SH.P.K.,**

Rr., Bregu i Diellit,Qendra e Re Tregtare,Nr.42-Prishtinë që përfaqëson:Ismajl Baftiari tel . 044-999-007, ne anën tjetër, janë pajtuar për:

**Kryrjen e shërbimeve të :** “Hartimi i Hartave Zonale për Komunën e Shtimes”,me numër Identifikues 617-2018-078-221

“Hartimi i Hartave Zonale për Komunën e Shtimes” me numër identifikues: 617-18-4454-2-2-1

#### **Neni 1 Lënda**

1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit te Shërbimeve:

“Hartimi i Hartave Zonale për Komunën e Shtimes” me nr. 617-18-4454-2-2-1

#### **Neni 2 Çmimi**

2.1 Çmimi total i shërbimeve duhet të jetë: 79.500.00€; [Shtatëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind euro] Euro.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit te Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

### Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);
- (f) [shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit].

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

### Neni 4 Komunikimet


4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.


4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën [shqipe] në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Ofruesin e Shërbimeve.

#### Për Autoritetin Kontraktues

|             |                                                                                     |
|-------------|-------------------------------------------------------------------------------------|
| Emri:       | Havë QARRI                                                                          |
| Pozita:     | U.D. Zyrtar përgjegjës i prokurimit                                                 |
| Nënshkrimi: |  |
| Data:       | 27.09.2018                                                                          |
| Vula:       |                                                                                     |

#### Për Ofruesin e Shërbimeve

|             |                                                                                     |
|-------------|-------------------------------------------------------------------------------------|
| Emri:       | ISMAJL BAFTIJAKI                                                                    |
| Pozita:     |  |
| Nënshkrimi: | DREJTOR                                                                             |
| Data:       | 27.09.2018                                                                          |
| Vula:       |                                                                                     |



## **PJESA II E KONTRATES**

## **KUSHTET E PËRGJITHSHME**

### **Neni 1 Përkufizimet**

1.1 “Kontratë” do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.

1.2 “Shërbimet” do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 “Ofrues i shërbimeve” është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 “Personeli” do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 “Çmimi i kontratës” do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 “Nënkontraktuesi” do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 “Palë” nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe “Palët” nënkupton të dy prej tyre.

1.8 “Autoriteti Kontraktues” nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 “KPK” nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 “KVK” nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

### **Neni 2 Ligji i aplikueshëm dhe gjuha**

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

### **Neni 3 Transferimi**

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguruesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

### **Neni 4 Nën-kontraktimi**

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues me rastin e dorëzimit të ofertës. Në rast të ndryshimit të nënkontraktuesve gjatë implementimit të kontratës, Ofruesi i Shërbimeve duhet të njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktin pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithë nënkontraktuesit e propozuar duhet të përmbushin kërkesat e përshtatshmërisë.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeht lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

## **Neni 5 Tatimet dhe Doganat**

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha taksat dhe doganat në pajtim me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Ofruesi i Shërbimeve, Nënkontraktuesit, dhe Personeli i tyre do t'i paguaj ato taksa, dogana, tarifa dhe detyrime të tjera që mund të vendosen sipas ligjit në fuqi, shuma e të cilave mendohet të ketë qenë e përfshirë në çmimin e kontratës.

## **Neni 6 Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve**

6.1 Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të kontratës nga të dy palët ose në një datë tjetër të mëvonshme siç mund të ceket në KVK.

6.2 Para fillimit të Shërbimeve, Ofruesi i Shërbimeve do të dorëzoj Autoritetit Kontraktues për miratim një Program që tregon metodat, aranzhimet, rendin dhe kohën për të gjitha aktivitetet. Shërbimet do të kryhen në pajtim me programin e miratuar.

6.3 Ofruesi i Shërbimeve do të filloj shërbimet sa më shpejt që është arsyeshëm e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.4 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, siç është e specifikuar në KVK. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktiviteteve.

6.5 Vendi i kryerjes së shërbimeve është i përcaktuar në KVK.

6.6 Përveç nëse palët pajtohen që të bëhet ndryshe, ekzekutimi i kontratës do të fillojë jo më vonë se 90 ditë pas njoftimit të dhënies së kontratës. Pas kësaj date Ofruesi i Shërbimeve do të ketë të drejtë të mos e ekzekutojë kontratën dhe ta marrë ndërprerjen e saj ose kompensimin për dëmin që i është shkaktuar. Ofruesit të Shërbimeve do t'i merret kjo e drejtë, përveç nëse e ushtron brenda 30 ditësh pas skadimit të periudhës 90-ditore.

## **Neni 7 Zgjatja e periudhës së përfundimit**

7.1 Ofruesi i Shërbimeve mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) forca madhore siç është e definuar në Nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëj një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

## **Neni 8 Forca madhore**

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marrë të gjitha masat e arsyeshme për të mënjeluar paaftësinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përdërisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

## **Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues**

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

(a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;

(b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;

(c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;

(d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;

(e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;

(f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetojë Autoriteti kontraktues;

(g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;

(h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

(i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;

(j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

## **Neni 10                   Ndërprerja nga ana e Ofruesit të Shërbimeve**

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;

b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose

c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paafte të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) të Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

## **Neni 11                   Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve**

11.1 Ofruesi i Shërbimeve do të kryej Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikën më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Ofruesi i Shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.5 Nëse Ofruesi i Shërbimeve është konsorcium i dy ose më tepër personave, të gjithë personat e tillë do të jenë bashkërisht dhe vazhdimisht të obliguar t'i plotësojnë kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi që të veprojë në emër të tij për qëllime të kësaj kontrate do të ketë autoritetin që të lidh konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojë personelin kyç të identifikuar në tender e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë ekzekutimit, dhe në bazë të kërkesës me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë për një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryen detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të propozuar të personelit kryesor, vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë janë thelbisht të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuara.

## Neni 12 Obligimet e Autoriteti Kontraktues

12.1 Autoriteti kontraktues do t'i ofrojë ofruesit të shërbimeve menjëherë ndonjë informacion dhe/ose dokumentacion në dispozicion të tij, që mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla do t'i kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunoj sa më shumë që është e mundur me Ofruesin e Shërbimeve për t'i siguruar informacione që ky i fundit mund t'i kërkoj në mënyrë të arsyeshme për kryerjen e kontratës.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "Menaxherin e Projektit", i ceku në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

## Neni 13 Dëmet e likuiduara

13.1 Ofruesi i Shërbimeve do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbres dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Ofruesit të Shërbimeve. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse Data e përfundimit është zgjatur pasi që janë paguar dëmet e likuiduara, Autoriteti kontraktues do të përmirësojë çdo pagesë të tepërt të dëmeve të likuiduara nga ofruesi i shërbimit, duke rregulluar certifikatën e ardhshme të pagesës.

## Neni 14 Siguria e ekzekutimit

14.1 Ofruesi i Shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mirë të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosëkzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Siguria do të vazhdoj të jetë valide 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

14.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

## Neni 15 Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

## Neni 16 Parimet e përgjithshme të pagesës

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Metoda dhe kushtet e pagesës që duhet t'i behet Ofruesit të Shërbimeve sipas kësaj Kontrate do të specifikohen në KVK.

16.2 Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.3 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.4 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar Ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtësore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.5 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.3, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.6 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.3 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

#### **Neni 17                      Kontrolli i kualitetit**

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është si në KVK.

#### **Neni 18                      Korrigjimi i defekteve**

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigjohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues.

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

#### **Neni 19                      Konsekuencat e Shkeljes se kontratës**

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur në Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) Dëme të përgjithshme; ose
- b) Dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

#### **Neni 20                      Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjeke për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpqien të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

#### **Neni 21                      Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**



21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

## **Neni 22 Dëmshpërblimi**

22.1 Ofruesi i shërbimeve do të mbroje dhe do të dëmshpërblej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do të jete përgjegjës për të gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshirë por jo kufizuar shpenzimet e tarifës së avokateve dhe shpenzimet në lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit të Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti të siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

## PJESA III E KONTRATES KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

*[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]*

| Kushtet e Përgjithshme të Kontratës               |           | Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
|---------------------------------------------------|-----------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Përshkrimi i nenit                                | Nr. Nenit |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| Ligji i zbatueshëm dhe gjuha                      | 2.1       | Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.                                                                                                                                                                                                                    |
|                                                   | 2.2       | Gjuha e përdorur do të jetë Shqip                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve               | 6.1       | Data e Fillimit të fillimit të Shërbimeve është : <i>01.10.2018</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           |
|                                                   | 6.4       | Data e Përfundimit është : <i>31.12.2019</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
|                                                   | 6.5       | Vendi i kryerjes së shërbimeve është: <b>“Hartimi i Hartave Zonale për Komunën e Shtimes”</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| Obligimet e Autoritetit Kontraktues               | 12.3      | Menaxheri i Projektit është :<br><br><i>Fatmir Rexhepi</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    |
| Dëmet e likuiduara                                | 13.1      | Norma e dëmeve të likuiduara është: 0.25% në ditë.<br><br>Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është 10% të çmimit final të kontratës.                                                                                                                                                                                                                                   |
| Siguria e ekzekutimit                             | 14.1      | Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës për 16 muaj.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  |
| Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve | 15.1      | Rreziqet dhe mbulimi nga sigurimi do të jenë:<br><br>a) Automjeti motorik i Palës së Tretë <i>[shëno shumën]</i><br>b) Përgjegjësia e Palës së Tretë <i>[shëno shumën]</i><br>c) Përgjegjësia ndaj punëdhënësit dhe kompensimi i punëtorëve <i>[shëno shumën]</i><br>d) Përgjegjësia profesionale <i>[shëno shumën]</i><br>e) Humbja ose dëmtimi i pajisjeve dhe pronës <i>[shëno shumën]</i> |
| Parimet e përgjithshme të                         | 16.1      | Orari i pagesës do të jetë: <i>[shëno orarin e pagesës]</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                   |

|                                                   |      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
|---------------------------------------------------|------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| pagesës                                           |      |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |
| Kontrolli i kualitetit                            | 17.1 | Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në vijim: <i>[shëno]</i><br><br>Periudha Garantuese e Defekteve është <i>[shëno datën]</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        |
| Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes               | 20.2 | <i>Zyra e Prokurimit</i>                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      |
| Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore | 21.1 | <i>[shëno te dyja]</i><br><br>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <i>[specifikoni gjykatën kompetente]</i> në pajtim me ligjin në Kosovë.<br><br>ose<br><br>b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh |

**Përshkrimi i detyrave për hartimin e**  
**HARTËS ZONALE TË KOMUNËS SË SHTIMES**

**1. Informata të përgjithshme**

- 1 Duke u nisur nga detyrimet e komunës së Shtimes që dalin prej Ligjit për Planifikim Hapësinor (Nr.04/L-174); si dhe nga gjendja momentale e planifikimit hapësinorë si rezultat edhe i kërkesave dhe ndryshimeve që ka sjell ligji i ri i planifikimit , duke pasur parasysh gjendjen e krijuar të komunës me zhvillime të shumta, jo të bazuara në plane, dhe jo të orientuara, e deri në një shkallë edhe të pa kontrolluara, si dhe kërkesat e vazhdueshme të investitorëve dhe pronarëve për zhvillim, Kuvendi i Komunës ka marrë Vendimin Npi-01/230 me datë 25.08.2017 , për fillimin e hartimit të Hartës Zonale të Komunës së Shtimes .

**1-1 Sipërfaqja dhe kufiri i HARTËS ZONALE TË KOMUNËS**

Harta Zonale e Komunës brenda kufirit të vet përfshinë tërë territorin e Komunës së Shtimes ( të gjitha zonat kadastrale).

Shtime përfshinë një sipërfaqe prej 134km<sup>2</sup> (kilometra katrorë).

**1-2 Baza legjislative**

Harta Zonale e Komunës duhet kuptuar si dokument i cili është një dokument multi-sektorial që përmes grafikoneve, fotografive, hartave dhe tekstit përcakton hollësisht llojin, destinimin, shfrytëzimin e planifikuar të hapësirës dhe masat e veprimit të cilat bazohen në kohëzgjatje dhe projeksione të arritshme të investimeve publike dhe private për tërë territorin e Komunës, për një periudhë së paku tetë (8) vjeçare.

Harta Zonale e Komunës duhet të hartohet në bazë të Ligjit për Planifikim Hapësinor (Nr.04/L-174), Udhëzimit Administrativ mbi Elementet dhe kërkesat themelore për hartim, zbatim dhe monitorim të Hartës Zonale të Komunës (24\2015); Ligjin për Ndërtimet ; Ligjin për Trashëgiminë Kulturore ; Ligjin mbi Rrugët ; Ligjin për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (Ligji nr.03/L - 230 i vitit 2010) , etj. dhe të jetë në pajtim me Planin Zhvillimor të Komunës dhe dokumentet tjera të planifikimit .

- Me qëllim që të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm dhe të baraspeshuar të planifikimit hapësinor për tërë territorin e Komunës si vlerë e përgjithshme, përmes qeverisjes së mirë, shfrytëzimit të përshtatshëm të tokës, mbrojtjes së mjedisit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

- Me qëllim që edhe të sigurojë qeverisje të qëndrueshme, shfrytëzim efikas të fondeve publike, parakushte për zhvillim social dhe ekonomik të baraspeshuar, rregullim të qëndrueshëm të hapësirës, duke siguruar trajtim të barabartë, lëvizje të lirë dhe qasje adekuate në shërbimet publike për qytetarët.
- Informatat e rëndësishme për përgatitjen e konceptit të zonimit por dhe kërkesave tjera në këtë konkurs projektimi duhet ti trajtoni dhe analizoni :

**Shtojca 1:** - Planin Zhvillimorë Komunal të Shtimes

**Shtojca 2:** - Planin Hapësinorë të Kosovës

**Shtojca 3:** - ligji për planifikimin hapësinor (nr.04/l-174),

Sqarim: Shtojca 1 mund te mirret ne Komunen e Shtimes,DPUKGJ

**Shtojca 4:** - Udhëzimin Administrativ mbi Elementet dhe kërkesat themelore për hartim,

zbatim dhe monitorim të Hartës Zonale të Komunës (24\2015),

ose Adresa:[http://mmph-rks.org/repository/docs/MINISTRI-UA-24-6557-2015\\_204668.pdf](http://mmph-rks.org/repository/docs/MINISTRI-UA-24-6557-2015_204668.pdf)

si dhe plana dhe ligje tjera që mundën të ju shërbejnë.

## **Përshkrimi i detyrave për hartimin e hartës zonale komunale të Shtimes**

### **1. Përgatitja e Hartës Zonale Komunale të Shtimes**

Harta Zonale Komunale duhet të trajtohet si një mjet për arritjen e qëllimeve dhe objektivave të Planit Zhvillimor Komunal dhe për shtrirjen hapësinore dhe gjeografike të tyre.

Në bazë të Hartës së Shfrytëzimit të Planifikuar të Tokës nga Planit Zhvillimor Komunal, Harta Zonale e Komunës duhet të ofroj elaboratin e hollësishëm të kufijve të zonave dhe kushteve zhvillimore për çdo zonë.

Harta Zonale e Komunës të jetë e bazuar në Planin Hapësinor të Kosovës, Hartën Zonale të Kosovës dhe interesat kombëtar të paraqitura si objektiva, plane dhe politika oficiale të Qeverisë.

Harta Zonale e Komunës duhet të merr parasysh mundësitë e integrimin e Planeve Rregulluese Urbane që janë në fuqi.

Harta Zonale e Komunës duhet të hartohet në përputhje me normat teknike të planifikimit hapësinor.

Harta Zonale e Komunës duhet të hartohet në formën e cila e bën më të lehtë përdorimin dhe lehtëson monitorimin dhe rishikimin.

Harta Zonale e Komunës duhet përmes pjesëmarrjes publike të merr parasysh kërkesat e të gjithë qytetareve si dhe kërkesat dhe nevojat speciale të personave me aftësi të kufizuara, të moshuarve, minoriteteve, fëmijëve, të rinjve dhe aspektet e ndjeshme gjinore

Harta Zonale e Komunës duhet të bazohet në aktivitetet zhvillimore hapësinore të cilat rrjedhin nga Plani Zhvillimor Komunal, përkatësisht nga harta e shfrytëzimit të planifikuar të tokës, planet zhvillimore sektoriale dhe plani i veprimit.

Harta Zonale e Komunës duhet të përcakton ndarjen precize të territorit të komunës në zona funksionale dhe për secilën zonë përcakton shfrytëzimet e tokës, kushtet zhvillimore dhe masat mbrojtëse për periudhën e planifikuar të zhvillimit.

Harta Zonale e Komunës duhet të përmban zonat funksionale të cilat rrjedhin nga Harta Zonale e Kosovës dhe Planet Hapësinore për Zona të Veçanta.

Gjatë hartimit të Hartës Zonale Komunale duhet mundësuar promovimin e veprimtarive të organizuara në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë, në zonat rurale në funksion të ruajtjes së tokës bujqësore kualitative dhe kulturave të ndryshme.

Gjatë hartimit të Hartës Zonale Komunale duhet mundësuar sigurimin e mbrojtjes së investimeve të infrastrukturës publike, sociale, teknike dhe zhvillimit të integruar e të arritshëm në funksion të transportit urban, ndër urban, rural dhe menaxhim të mbeturinave.

Gjatë hartimit të Hartës Zonale Komunale duhet mundësuar promovimin e mundësive të barabarta për banim të qëndrueshëm për familjet që nuk janë në gjendje ekonomike t'i përballojnë ofertat e tregut të banimit me qëllim të stabilitetit social, shëndetit dhe zhvillimit të mirëqenies njerëzore për të gjithë qytetarët nën administrimin territorial të komunës.

Gjatë hartimit të Hartës Zonale Komunale duhet mundësuar sigurimin e mundësisë së shfrytëzimit të tokës në koordinim me komunat fqinje, qeverinë qendrore dhe agjencitë tjera, veçanërisht në lidhje me resurset dhe shërbimet që shtrihen përtej kufijve të komunës apo që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në atë komunë;

1. sigurimin që shfrytëzimi i tokës të përfshijë udhëzime të planifikimit dhe obligimet të cilat rrjedhin nga dokumentet dhe planet hapësinore për rajon më të gjerë e të cilat afektojnë komunën/komunat;
2. sigurimin e përfshirjes së elementeve hapësinore të transportit, zhvillimit ekonomik, shoqëror, mjedisor dhe politikat tjera strategjike për komunën në procesin e planifikimit hapësinor; dhe
3. sigurimin e rishikimit efikas të propozimeve për zhvillim dhe kërkesave për leje ndërtimore për sqarim dhe përshpejtim të procedurës.

Gjatë hartimit të Hartës Zonale Komunale duhet të bazuar në parimet e përgjithshme si në parimin e demokracisë, subsidiaritetit, pjesëmarrjes, integritit, proporcionalitetit dhe parandalimit.

Përveç parimeve të përgjithshme të përcaktuara në nenin 4 të Ligjit për Planifikim Hapësinor (Nr.04/L-174) dhe në nenin 4 të Udhëzimit Administrativ mbi Elementet dhe kërkesat themelore për hartim, zbatim dhe monitorim të Hartës Zonale të Komunës (24\2015) , gjatë hartimit të Hartës Zonale Komunale duhet të bazuar në parimet specifike si në vijim:

1. promovimin e objektivave të planeve zhvillimore sektoriale dhe hartat e shfrytëzimit të planifikuar të tokës të përcaktuara në Planin Zhvillimor Komunal;
2. promovimin e objektivave të komunitetit, ashtu si janë deklaruar në Planin Zhvillimor Komunal si: krijimi i mundësive të reja për punë, ofrimi i banimit të përballueshëm, etj.;
3. promovimin e shëndetit dhe sigurisë publike dhe të mirëqenies së përgjithshme;
4. sigurimin e llojllojshmërisë së shfrytëzimit dhe densiteteve të përshtatshme me karakterin e komunës që pasqyrojnë nevojat aktuale dhe ato të planifikuara;
5. nevoja për të balancuar interesin publik me të drejtat e pronës private dhe shfrytëzimin të arsyeshëm të pronës në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe legjislacionin në fuqi;
6. sigurimin e zhvillimit të planifikuar të bazuar në:
  1. modelet e shfrytëzimit të tokës të bazuara të Planit Zhvillimor Komunal;
  2. gjendjen ekzistuese, marrë parasysh mjedisin e ndërtuar faktik dhe të drejtat pronësore me qëllim që hartimi i dokumenteve të planifikimit hapësinor të jetë real dhe i zbatueshëm;
  3. karakteristikat natyrore të tokës, përfshirë përshtatshmërinë e shfrytëzueshmërisë të bazuar në karakteristikat e dheut, topografisë dhe ndjeshmërisë ndaj ndotjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore;
  4. kapacitetet ekzistuese dhe të planifikuara të shërbimeve dhe ndërtesave publike dhe private;
  5. nevoja për të formësuar dhe balancuar zhvillimin urban dhe rural;
  6. harmonizimin e kërkesave të interesit publik me të drejtat në pronën private nëpërmjet shfrytëzimit të arsyeshëm të pronës;
  7. promovimin e teknikave inovative për zhvillim;

7. sigurimin e kontrollit të ndotjes së ajrit, ujit, tokës, ujërave tokësore dhe ndotjes akustike;
8. sigurimin e masave mbrojtëse ndaj zjarrit, erozionit, rrëshqitjes së dheut, ortekeve, tërmeteve dhe vërshimeve;
9. sigurimin e mbrojtjes së karakterit natyror, historik, kulturor dhe peizazhor të territorit të komunës;
10. ruajtjen dhe promovimin e traditës në prodhimtarinë bujqësore, pylltari, peshkim, rekreacionit dhe aktiviteteve në hapësirë të hapur;

## **PËRMBAJTJA E HARTËS ZONALE KOMUNALE**

Harta Zonale e Komunës duhet të përmban pjesën tekstuale dhe kartografike të cilat prezantohen në mënyrë digjitale dhe në format të shtypur për miratim dhe nënshkrim formal.

### **Pjesa tekstuale e Hartës Zonale të Komunës**

- Pjesa tekstuale e Hartës Zonale të Komunës duhet të përmban kushtet zhvillimore dhe masat mbrojtëse për të gjitha zonat të tërë hapësirës së komunës, përfshirë zhvillimin e infrastrukturës teknike, publike dhe sociale, të gjitha në format A4, me pjesët vijuese:
  1. Hyrje;
  2. Arsyetim;
  3. Kushtet e përgjithshme për zhvillim për të gjitha zonat;
  4. Lista e zonave dhe Lista e zonave Mbishtresore;
  5. Zonat e destinuara dhe kushtet zhvillimore përfshirë Kushtet ndërtimore;
  6. Zonat Mbishtresore dhe Kushtet Zhvillimore;
  7. Infrastruktura teknike;
  8. Infrastruktura rrugore;
  9. Infrastruktura publike dhe sociale;
  10. Arsyetimi për nevojën e hartimit të planeve rregulluese të hollësishme të planifikuara;



11. Plani i Veprimit për Zbatim;  
Administrimi, zbatimi dhe monitorimi i zbatimit;
12. Ndryshim plotësimit dhe përjashtimet; dhe
13. Përkufizimet

### **Pjesa Hartografike e Hartës Zonale të Komunës**

Pjesa Hartografike e Hartës Zonale të Komunës përbëhet nga hartat e integruara sipas fushave tematike zhvillimore të tërë hapësirës së komunës të përgatitur në sistemin zyrtar të planifikimit hapësinor në një platformë GIS, i cili paraqet informacione thelbësore për ti shpjeguar publikut për mundësitë e shfrytëzimit të tokës, kushtet zhvillimore dhe masat mbrojtëse. Këto harta përfshijnë por nuk kufizohen vetëm në të mëposhtmet:

- 3.1. shtresat e përgjithshme;
  - 3.2. Harta e të dhënave bazë;
  - 3.3. Harta e sipërfaqeve dhe ndërtesave me rëndësi për Kosovën;
  - 3.4. Harta zonale e shfrytëzimit bazë të tokës;
  - 3.5. Harta zonale e shfrytëzimit të tokës bujqësore;
  - 3.6. Harta e zonave mbishtresore;
  - 3.7. Hartat e korridoreve dhe infrastrukturës rrugore;
  - 3.8. Hartat e infrastrukturës publike dhe sociale;
  - 3.9. Harta e infrastrukturës teknike; dhe
  - 3.10. Harta me Plane Rregulluese Urbane në fuqi.
- Pjesa hartografike hartohet sipas kërkesave dhe specifikave teknike të vendosura me Udhëzimin Administrativ mbi Bazën e të Dhënave Hapësinore.
  - Të gjitha dosjet burimore dhe GIS të jenë të formatit që është i pranueshëm për komunën dhe bëhen pronë e komunës.
  - Komuna përditëson bazën e të dhënave hapësinore dhe pjesën e printuar të Hartës Zonale të Komunës për të gjitha ndryshim plotësimit dhe përjashtimet pesëmbëdhjetë (15) ditë pas miratimit të tyre.
  - Komuna përditëson bazën e të dhënave hapësinore dhe pjesën e printuar të Hartës Zonale të Komunës me të gjitha lejet ndërtimore të lëshuara.

Informatat tjera që nuk i keni të prezantuara në këtë pjesë të detyrës projektuese qoftë lidhur me procesin,përmbajtjen ,elementet tjera dhe sqarimet i gjeni në Udhëzimin Administrativ mbi Elementet dhe kërkesat themelore për hartim, zbatim dhe monitorim të Hartës Zonale të Komunës (24\2015),si dhe ligjin për planifikimin hapësinor (nr.04/l-174),udhëzime e ligje tjera relevante si dhe dokumente tjera planifikimi.

## **2. Ngritja e kapaciteteve për stafin e komunës, për ti krijuar mundësitë e gasjes stafit komunal në procesin e përgatitjes dhe zbatimit e Hartës Zonale Komunale të Shtimes.**

Operatori duhet ofroj trajnime për stafin e komunës,ashtu që të aftësohet stafi i nevojshëm për të kuptuar Hartën Zonale Komunale, si dhe përdorur GIS-in, edhe atë në fillim të procesit ,ashtu që të aftësohet stafi i nevojshëm komunal për të kontribuar në përgatitjen Hartën Zonale Komunale,si dhe në përfundim të procesit të përgatitjes së Hartës Zonale Komunale, prapë duhet organizuar trajnime ashtu që të aftësohet stafi i nevojshëm për të zbatuar Hartën Zonale Komunale si dhe përdorur GIS-in në zbatim

## **3. Përkrahje në organizimin dhe mirëvajtjen e Shqyrtimit Publik në procesin e Hartimit të hartës Zonale Komunale të Shtimes**

Duke kuptuar shqyrtimin publik si ngjarje e hapur për pjesëmarrje publike, të zhvilluara në vende të përshtatshme nga autoriteti i planifikimit hapësinor, i cili përmes njoftimit publik fton qytetarët, ekspertët dhe palët e interesuara për të parashtruar kundërshtimet, komentet apo sugjerimet, para finalizimit të dokumentit të planifikimit hapësinor,operatori ekonomik duhet të përkrahë organizimin e shqyrtimit publik në aspektin profesional.

## **4. Përkrahje në organizimin dhe mirëvajtjen e Takimit në MMPH në procesin e Hartimit të hartës Zonale Komunale të Shtimes**

Duke kuptuar se Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë është përgjegjëse për të bashkërenduar vlerësimin e përputhshmërisë së Hartës Zonale të Komunës me planin hapësinor të Kosovës dhe Hartën zonale të Kosovës, si dhe të revidimit të tyre me të dhënat digjitale bazë dhe normat teknike të planifikimit hapësinor dhe me vendim njofton autoritetin përgjegjës komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor për: miratimin e Hartës zonale të komunës brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e dorëzimit,operatori ekonomik duhet të përkrahë organizimin e një prezantimi publik në MMPH ,përkrahja duhet të jetë në aspektin profesional për prezantimi publik në MMPH dhe plotësimin dhe ndryshimin e hartës zonale komunale nëse kërkohet nga MMPH.


## **5. Përkrahje në organizimin dhe mirëvajtjen e Takimeve me zonën urbane dhe zonat rurale në procesin e Hartimit të hartës Zonale Komunale të Shtimes**

Operatori ekonomik duhet së bashku me autoritetin komunal të organizoj disa takime në zonën urbane dhe zonat rurale ,në funksion të plotësimit të kërkesave për pjesëmarrje,transparencë si

dhe gjithë përfshirje dhe cilësi të dokumentit ,përkrahja duhet të jetë në aspektin profesional për përgatitjen dhe organizimin dhe mbajtjen e takimeve dhe prezantimeve publik



Shtojca 5. Pozita e Komunës së Shtimes në Kosovë



Shtojca 6. Harta e Komunës së Shtimes me ndarjen administrative

| Përshkrimi i qmimit në bazë të termave të referencës                                       |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |        |       |                                                                             |                   |               |
|--------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------|-------|-----------------------------------------------------------------------------|-------------------|---------------|
| Nr. i art.                                                                                 | Përshkrimi                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     | Njësia | Sasia | Shënim                                                                      | Vendi i origjines | Çmimi         |
| Aktiviteti nr.                                                                             |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                |        |       |                                                                             |                   | Çmimi total € |
| I. PËRCAKTIMI I EKITIT PUNUES KOMUNAL DHE GRUPEVE TË INTERESIT                             | a. Përcaktimi i grupit punues Komunal<br>b. Përcaktimi i grupeve të interesit<br>c. Finalizimi i planit të punës dhe planit dinamik<br>d. Prezantimi i procesit të përgatitjes së Hartës Zonale të Komunës para punonjësve komunal<br>e. Prezantimi i procesit të përgatitjes së Hartës Zonale të Komunës para qytetarëve                                                      | Copë   | 1     | Komplet aktivitetet nga përshkrimi dhe të gjitha zhvillimet që lidhen me to | Kosovë            | 7,000.00 €    |
| II. PËRFSHIRJA I DHE KONSOLIDIMI I TË DHËNAVE EKZISTUESE TË DOKUMENTEVE HAPËSINORE NË FUQI | a. Përshirja dhe konsolidimi të dhënave hartografike<br>b. Migrimi i dhe konsolidimi të kushteve zhvillimore dhe kushteve ndërtimore ekzistuese                                                                                                                                                                                                                                | Copë   | 1     | Komplet aktivitetet nga përshkrimi dhe të gjitha zhvillimet që lidhen me to | Kosovë            | 7,000.00 €    |
| III. PËRGATITJA E ARSYETIMEVE                                                              | a. Përgatitja e Arsyelimeve                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                    | Copë   | 1     | Komplet aktivitetet nga përshkrimi dhe të gjitha zhvillimet që lidhen me to | Kosovë            | 4,000.00 €    |
| IV. VLERËSIMI I PËRSHTATSHËMERISË DHE NDRYSHIMI I KUSHTEVE ZHVILLIMORE EKZISTUESE          | a. Vlerësimi i përshtatshmërisë dhe ndryshimi i kushteve zhvillimore ekzistuese<br>b. Ndryshimi i kushteve zhvillimore ekzistuese                                                                                                                                                                                                                                              | Copë   | 1     | Komplet aktivitetet nga përshkrimi dhe të gjitha zhvillimet që lidhen me to | Kosovë            | 6,500.00 €    |
| V. PËRGATITJA E KUSHTEVE TË PËRGJITHSHME ZHVILLIMORE                                       | a. Krijimi i kushteve bazë të përgjithshme zhvillimore<br>b. Prezantimi i kushteve të përgjithshme para ekipit komunal punues dhe grupeve të interesit<br>c. Përmirësimi i kushteve të përgjithshme zhvillimore<br>d. Prezantimi i kushteve të përgjithshme zhvillimore para qytetarëve                                                                                        | Copë   | 1     | Komplet aktivitetet nga përshkrimi dhe të gjitha zhvillimet që lidhen me to | Kosovë            | 5,000.00 €    |
| VI. PËRGATITJA E KUSHTEVE ZHVILLIMORE SIPAS ZONAVE SPECIFIKE                               | a. Krijimi i kushteve zhvillimore<br>b. Prezantimi i kushteve zhvillimore dhe kushteve ndërtimore para ekipit komunal punues dhe grupeve të interesit<br>c. Përmirësimi i kushteve zhvillimore dhe kushteve ndërtimore<br>d. Prezantimi i kushteve zhvillimore dhe kushteve ndërtimore para qytetarëve                                                                         | Copë   | 1     | Komplet aktivitetet nga përshkrimi dhe të gjitha zhvillimet që lidhen me to | Kosovë            | 5,000.00 €    |
| VII. PËRGATITJA E KUSHTEVE ZHVILLIMORE PËR ZONAVE MBISHTRESORE                             | a. Krijimi i kushteve zhvillimore për zonat mbishtresore<br>b. Prezantimi i kushteve zhvillimore për zonat mbishtresore para ekipit komunal punues dhe grupeve të interesit<br>c. Përmirësimi i kushteve zhvillimore për zonat mbishtresore<br>d. Prezantimi i kushteve zhvillimore për zonat mbishtresore para qytetarëve                                                     | Copë   | 1     | Komplet aktivitetet nga përshkrimi dhe të gjitha zhvillimet që lidhen me to | Kosovë            | 6,000.00 €    |
| VIII. PËRGATITJA E KUSHTEVE ZHVILLIMORE PËR INFRASTRUKTURËN RRUGORE                        | a. Krijimi i kushteve zhvillimore për infrastrukturën rrugore<br>b. Prezantimi i kushteve zhvillimore për infrastrukturën rrugore para ekipit komunal punues dhe grupeve të interesit<br>c. Përmirësimi i kushteve zhvillimore për infrastrukturën rrugore<br>d. Prezantimi i kushteve zhvillimore për infrastrukturën rrugore para qytetarëve                                 | Copë   | 1     | Komplet aktivitetet nga përshkrimi dhe të gjitha zhvillimet që lidhen me to | Kosovë            | 5,000.00 €    |
| IX. PËRGATITJA E KUSHTEVE ZHVILLIMORE PËR INFRASTRUKTURËN TEKNIKE                          | a. Krijimi i kushteve zhvillimore për infrastrukturën teknike<br>b. Prezantimi i kushteve zhvillimore për infrastrukturën teknike para ekipit komunal punues dhe grupeve të interesit<br>c. Përmirësimi i kushteve zhvillimore për infrastrukturën teknike<br>d. Prezantimi i kushteve zhvillimore për infrastrukturën teknike para qytetarëve                                 | Copë   | 1     | Komplet aktivitetet nga përshkrimi dhe të gjitha zhvillimet që lidhen me to | Kosovë            | 5,000.00 €    |
| X. PËRGATITJA E KUSHTEVE ZHVILLIMORE PËR INFRASTRUKTURËN PUBLIKE DHE SOCIALE               | a. Krijimi i kushteve zhvillimore për infrastrukturën publike dhe sociale<br>b. Prezantimi i kushteve zhvillimore për infrastrukturën publike dhe sociale para ekipit komunal punues dhe grupeve të interesit<br>c. Përmirësimi i kushteve zhvillimore për infrastrukturën publike dhe sociale<br>d. Prezantimi i kushteve zhvillimore për infrastrukturën publike dhe sociale | Copë   | 1     | Komplet aktivitetet nga përshkrimi dhe të gjitha zhvillimet që lidhen me to | Kosovë            | 6,000.00 €    |

|                                                                                                                                         |                                                                                                                                        |      |   |                                                                              |        |             |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------|---|------------------------------------------------------------------------------|--------|-------------|
| XI. PËRGATITJA E KUSHTEVE ZHVILLIMORE PËR KUSHTEVE ZHVILLIMORE PËR VENDORANIMET JOFORMALE                                               | b. Prezantimi i kushteve zhvillimore për vendbanimet joformale para ekipit komunal punues dhe grupeve të interesit                     | Copë | 1 | Komplet aktivitetet nga përkshkrimi dhe të gjitha zhvillimet që lidhen me to | Kosovë | 3,500.00 €  |
|                                                                                                                                         | c. Përmirësimi i kushteve zhvillimore për vendbanimet joformale                                                                        | Copë | 1 | Komplet aktivitetet nga përkshkrimi dhe të gjitha zhvillimet që lidhen me to | Kosovë | 4,000.00 €  |
|                                                                                                                                         | d. Prezantimi i kushteve zhvillimore për vendbanimet joformale para banorëve të vendbanimeve joformale                                 | Copë | 1 | Komplet aktivitetet nga përkshkrimi dhe të gjitha zhvillimet që lidhen me to | Kosovë | 8,000.00 €  |
|                                                                                                                                         | a. Përcaktimi i zonave të cilat duhet të trajtohen me plane rregulluese të hollësishme                                                 | Copë | 1 | Komplet aktivitetet nga përkshkrimi dhe të gjitha zhvillimet që lidhen me to | Kosovë | 2,000.00 €  |
| XII. PËRCAKTIMI I ZONAVE TË CILAT DUHET TË TRAJTOHEN ME PLANE RREGULLUESE TË HOLLËSISHME                                                | a. Krijimi i planit të veprimit për zbatim                                                                                             | Copë | 1 | Komplet aktivitetet nga përkshkrimi dhe të gjitha zhvillimet që lidhen me to | Kosovë | 500.00 €    |
|                                                                                                                                         | b. Prezantimi i planit të veprimit për zbatim para ekipit komunal punues dhe grupeve të interesit                                      | Copë | 1 | Komplet aktivitetet nga përkshkrimi dhe të gjitha zhvillimet që lidhen me to | Kosovë | 1,000.00 €  |
|                                                                                                                                         | c. Përmirësimi i planit të veprimit për zbatim                                                                                         | Copë | 1 | Komplet aktivitetet nga përkshkrimi dhe të gjitha zhvillimet që lidhen me to | Kosovë | 500.00 €    |
|                                                                                                                                         | d. Prezantimi i planit të veprimit për zbatim para qytetarëve                                                                          | Copë | 1 | Komplet aktivitetet nga përkshkrimi dhe të gjitha zhvillimet që lidhen me to | Kosovë | 1,000.00 €  |
| XIII. PËRGATITJA E PLANIT TË VEPRIMIT PËR ZBATIM                                                                                        | a. Krijimi i planit të administrimit, zbatimit dhe monitorimit të zbatimit                                                             | Copë | 1 | Komplet aktivitetet nga përkshkrimi dhe të gjitha zhvillimet që lidhen me to | Kosovë | 500.00 €    |
|                                                                                                                                         | b. Prezantimi i planit të administrimit, zbatimit dhe monitorimit të zbatimit punues dhe grupeve të interesit                          | Copë | 1 | Komplet aktivitetet nga përkshkrimi dhe të gjitha zhvillimet që lidhen me to | Kosovë | 1,000.00 €  |
|                                                                                                                                         | c. Përmirësimi i planit të administrimit, zbatimit dhe monitorimit të zbatimit                                                         | Copë | 1 | Komplet aktivitetet nga përkshkrimi dhe të gjitha zhvillimet që lidhen me to | Kosovë | 500.00 €    |
|                                                                                                                                         | a. Përgatitja e përkshkrimeve të përkufizimeve                                                                                         | Copë | 1 | Komplet aktivitetet nga përkshkrimi dhe të gjitha zhvillimet që lidhen me to | Kosovë | 500.00 €    |
| XIV. PËRGATITJA E PËRKUFIZIMEVE                                                                                                         | a. Konsolidimi dhe përfundimi i përmbajtjes dhe dërgimi i dokumentit për të fituar pëlqimin e MMPH-së për fillimin e shqyrtimit publik | Copë | 1 | Komplet aktivitetet nga përkshkrimi dhe të gjitha zhvillimet që lidhen me to | Kosovë | 500.00 €    |
|                                                                                                                                         | a. Shqyrtimi publik i Hartës Zonale të Komunës                                                                                         | Copë | 1 | Komplet aktivitetet nga përkshkrimi dhe të gjitha zhvillimet që lidhen me to | Kosovë | 1,000.00 €  |
|                                                                                                                                         | a. Përgatitja e raportit të shqyrtimit publik                                                                                          | Copë | 1 | Komplet aktivitetet nga përkshkrimi dhe të gjitha zhvillimet që lidhen me to | Kosovë | 500.00 €    |
|                                                                                                                                         | a. Miratimi i Hartës Zonale të Komunës nga MMPH-se                                                                                     | Copë | 1 | Komplet aktivitetet nga përkshkrimi dhe të gjitha zhvillimet që lidhen me to | Kosovë | 500.00 €    |
| XV. KONSOLIDIMI DHE PËRFUNDIMI I PËRMBAJTJES DHE DËRGIMI I DOKUMENTIT PËR TË FITUAR PËLQIMIN E MMPH-SË PËR FILLIMIN E SHQYRTIMIT PUBLIK | a. Miratimi i Hartës Zonale të Komunës nga Kuvendi Komunal                                                                             | Copë | 1 | Komplet aktivitetet nga përkshkrimi dhe të gjitha zhvillimet që lidhen me to | Kosovë | 500.00 €    |
|                                                                                                                                         | a. Vendosija dhe sistemi i Hartë Zonale të Komunës së miratuar në rrejtin kompjuterik të Komunës                                       | Copë | 1 | Komplet aktivitetet nga përkshkrimi dhe të gjitha zhvillimet që lidhen me to | Kosovë | 1,500.00 €  |
|                                                                                                                                         | a. Miratimi i Hartës Zonale të Komunës nga Kuvendi Komunal                                                                             | Copë | 1 | Komplet aktivitetet nga përkshkrimi dhe të gjitha zhvillimet që lidhen me to | Kosovë | 500.00 €    |
|                                                                                                                                         | a. Vendosija dhe sistemi i Hartë Zonale të Komunës së miratuar në rrejtin kompjuterik të Komunës                                       | Copë | 1 | Komplet aktivitetet nga përkshkrimi dhe të gjitha zhvillimet që lidhen me to | Kosovë | 1,500.00 €  |
| KOSTOJA TOTALE E PROPOZIMIT FINANCIAR 1                                                                                                 |                                                                                                                                        |      |   |                                                                              |        | 79,500.00 € |



*Handwritten signature*

## PJESA III. OFERTA FINANCIARE<sup>2</sup>

Për: KOMUNA SHTIME

(në vazhdim të tekstit "Autoriteti Kontraktues")

Titulli i konkursit të projektimit: "Hartimi i Hartave Zonale për Komunën e Shtimes"-  
Ritenderim

Zonja/Zotërinjë

1. Ne, të nënshkruarit, ofrojmë që të dorëzojmë projektimin e detajuar inxhinierik për konkursin e projektimit të lartë cekur në pajtim me Dosjen e juaj të Konkursit të Projektimit Nr. 617-18-5421-2-2-3 dhe Koncept Propozimin.

2. Propozimi jonë Financiar për projektimin e radhës (projektimin e detajuar inxhinierik) është në shumë prej: Çmimi total i tenderit është:

79.500.00 €

3. [Nëse koncepti i projektit jonë fiton për fazën e radhës së projektimit, ne marrim përsipër të bëjmë nënshkrim të kontratës dhe të dorëzojmë "projektimin e detajuar inxhinierik" brenda [365 dite] pas nënshkrimit të kontratës.

4. Operatori Ekonomik [dhe nënkontraktuesit tonë] kanë këtë nacionalitet: [shëno nacionalitetin]

5. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender me të drejtën tonë të udhëhequr nga ne. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formë tjetër.

[Në rast të konsorciumit]

[Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet] si partner në konsorcium të udhëhequr nga [shëno emrin e udhëheqësit]. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës].

6. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK

### E DORËZUAR NGA

| IDENTIFIKIM I OPERATORIT EKONOMIK |                                                        |
|-----------------------------------|--------------------------------------------------------|
| EMRI I KOMPANISË                  | INSTITUTI PËR SHKENCË DHE TEKNOLOGJI "INSI" SH.P.K     |
| ADRESA E PLOTE                    | BREGU I DIELLIT, QENDRA E RE TREGTARË NR42 - PRISHTINË |
| PËRFAQËSUAU NGA:                  |                                                        |

—2— Aplikohet vetëm në rast të kontratës për shërbime pas konkursit që do ti jepet fituesit apo njërit nga fituesit e konkursit